

TREGIMI I PEJGAMBERIT

ADEM



Özkan Öze

Ilustroi: Sevgi İçigen

TREGIMI I PEJGAMBERIT
ADEM



Në pamjet që ilustrojnë libërthat e kësaj serie botimesh për fëmijë nuk do të shihni asnjë nga fytyrat e pejgamberëve. Kjo sepse muslimanët nuk bëjnë portrete të pejgamberëve, për shkak të respektit që ndiejnë ndaj tyre.



BOTIMET E KRYESISË SË ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË: 1706/1
Libra për fëmijë: 349/1

Drejtuesi i botimeve:

Dr. Fatih Kurt

Koordinatori i botimeve:

Lokman Arslan

Analizimi i veprës:

Hale Şahin

Elif Erdem

Editor

Zeynep Ulviye Özkan

Përktheu

Florida Kulla

Redaktor gjuhësor

Fatjon Çuka

Ndjekja e botimit

Uğur Altuntop

Botimi

Bapak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

Tel.: +90 312 397 16 17

Botimi i tretë, Ankara 2019

2019-06-Y-0003-1706

ISBN 978-605-7730-91-6

Numri i certifikatës: 12930

Vendimi i komisionit të hetimit të veprave : 12.11.2019/111

© Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë

Kontakt

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya – ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr





Në krye të herës ishte vetëm Allahu.

Krahas tij s'kish asgjë tjetër.

Më pas Allahu deshi të krijonte

dhe tha "BËHU!"


Sepse kur Allahu dëshiron të krijojë diçka, thotë

thjesht "BËHU!"

Dhe ajo bëhet..



Allahu tha "BËHU!" dhe u krijuan yjet
Allahu tha "BËHU!" dhe u krijua bota.
U krijua qielli, retë, pemët, lulet dhe frutat..



Allahu tha "BËHU!" dhe u krijuan bletët, fluturat dhe
milingonat

U krijuan zogjtë, peshqit dhe gazelat..

U krijuan tigrat dhe elefantët

Allahu tha "BËHU!" dhe u krijuan delet

U krijuan kuajt që vrapojnë me nxitim dhe lopët e
mëdha.





Dhe Allahu tha "BËHU!"
U krijua një njeri prej dheu.
Ky ishte njeriu i parë...
Allahu i vuri emrin Adem.
Ademi qe fillimisht në xhennet
Dhe ishte shumë i lumtur. Por qe i vetmuar!
Ndërkohë që çdo gjë kishte një "shok" apo "shoqe".
Ah sikur të kish edhe Ademi një shok apo shoqe!
Dhe Allahu krijoi Havanë, si shoqe për Ademin.



Ademi dhe Havaja kalonin çaste të bukura së bashku,
sepse xhenneti ishte një vend shumë i bukur.
Atje kishte çdo gjë që dëshironin.
Lule të llojlojshme dhe një sërë pemësh frutore...







Mund të ngjiteshin te të gjitha pemët,
mund të hanin nga të gjitha frutat
Por vetëm nga njëra jo!
Allahu u kishte thënë: "Ju lutem, mos iu afroni kësaj
peme!"
Ajo pemë ishte e ndaluar. Edhe frutat e saj ishin të
ndaluara!

Ademi dhe Havaja ishin shumë të lumtur në xhennet
Por shejtani nuk ishte aspak i lumtur,
sepse ai e urrente Ademin.
Pa dyshim që edhe Havanë nuk e donte aspak.



Allahu e kishte krijuar shejtanin prej zjarri.
Ai nuk ishte një melek, por rrinte bashkë me melekët.
Kur Allahu krijoi Ademin, i urdhëroi melekët që të
tregonin respekt ndaj tij.
Melekët e plotësuan menjëherë këtë urdhër.





Ndërsa shejtani iu përgjigj Allahut duke thënë:
“Mua më krijove prej zjarri, ndërsa Ademin
prej dheu!”


Dhe vazhdoi: “Unë jam më i lartë se ai!
Kurrë nuk do të tregoj respekt ndaj tij!”
Ky ishte padyshim një kundërshtim dhe rebelim
ndaj Allahut

Madje një mungesë e madhe respekti!



Allahu u zemërua me shejtanin
dhe e dëboi atë nga prania e tij.
Prandaj shejtani e urrente Ademin.
Duhej të hakmerrej patjetër ndaj tij.
Por si?





Në xhenet ishte një ditë e bukur.
Shejtani u fsheh pas një peme.
Po vëzhgonte Ademin dhe Havanë.
Mendoj me vete: "Më duhet të bëj diçka
që këta të dëbohen nga këtej!"
Dhe thuri një plan tinëzar.

Doli papritur nga vendi ku ishte fshehur duke thënë:

“Përshëndetje Adem! Përshëndetje Hava!”


Ademi dhe Havaja thanë: “Edhe ne të
përshëndesim ty!”

Shejtani tha: “Ah sa merakosem për ju!”

Ademi e pyeti: “Përse?”

Ç’kemi ne që mërzhitesh ti?”






Shejtani tha: "Së shpejti do të dilni nga xhenneti, prandaj!"

Ademi iu përgjigj: "Do të dalim?"

Shejtani i tha: "Më vjen keq, por po, ashtu është!

Një ditë do të vdisni dhe do të dilni nga këtu!"



Ademi tha: "Këtu jemi në xhennet!
Këtu nuk ka vdekje!"
Shejtani ia ktheu: "Ti ashtu pandeh!"
Ademi u frikësua shumë.
Havaja edhe më shumë..
Shejtani tha: "Por mos u merakosni!
Ka një zgjidhje edhe për këtë."
Dhe duke treguar pemën që ishte larg tyre, tha:
"Nëse hani nga frutat e asaj peme nuk do të vdisni
kurrë.
Do të qëndroni përjetësisht në xhennet!"



Ademi ia ktheu: "Por ajo pemë është e ndaluar!

Kurrë nuk duhet të hamë fruta prej saj!"

Havaja tha: "Ajo na është ndaluar ne!"

Ndërsa shejtani u përgjigj: "Vallahi po flas drejt!

Bil-lahi po flas drejt!"
Dhe shprehu betim edhe një herë...
Kur shejtani u betua në këtë mënyrë,
Ademi dhe Havaja besuan menjëherë tek ai.
Gjithsesi nuk ia kishin idenë se ç'ishte gënjeshtër.
Vajtën dhe hëngrën nga frutat e pemës së ndaluar.
Shejtani qeshi: "Ha ha ha ha ha!
I mashtrova ata! I mashtrova ata!"





Ndërkohë që Allahu i pati lajmëruar Ademin
e Havanë
dhe u kishte thënë se shejtani ishte një
armik për ta,
se duhet të ishin të kujdesshëm ndaj tij.
Ademi tha: "Mjerë ne! Ç'bëmë ne!
Këta janë frutat e pemës së ndaluar,
Kurrë nuk duhet ta hanim atë!"
Havaja nisi të qajë.
Që të dy ishin penduar vërtet shumë nga
veprimi që kryen.


Ademi dhe Havaja kërkuan falje nga Allahu.

Allahu i fali ata.

Sepse Allahu e donte faljen.

Mirëpo tashmë nuk mund të qëndronin në
xhennet

Dhe Allahu i dërgoi ata në botë.






Ademi dhe Havaja qëndruan për vite të tëra
në botë.

Nuk ishte aq e lehtë të jetoje në botë.

Por Allahu i kishte mësuar çdo gjë Ademit
Për shembull, se si të mbillte grurë dhe të gat-
ante bukë!

Të kapte peshk, patjetër edhe të ndizte zjarr!



Më pas Ademi dhe Havaja patën shumë fëmijë.
Allahu i dha Ademit detyrën e profetësisë.
Pejgamberi Adem u tregoi fëmijëve të tij gjithnjë për
Allahun dhe se si shejtani i kishte mashtruar ata...
Dhe se sa vend i bukur ishte xhenneti....
Ja, pra, çdo gjë kështu nisi.
Të gjithë ne jemi fëmijët e Ademit!

